



KËSHILLI KOMBËTAR I PAGESAVE

në funksion të modernizimit të shërbimeve, zgjerimit të përfshirjes dhe rritjes së bashkëpunimit në mes të akterëve të ekosistemit të tregut të pagesave në Republikën e Kosovës

organizon

Takimin e parë (I) për vitin 2025

Datë: 17/06/2025

Lokacioni: Salla ARTANA - Swiss Diamond Hotel, Prishtinë



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI KOMBËTAR I PAGESAVE

Diskutim i hapur dhe prezantimi i konkluzioneve dhe rekomandimet nga takimi:

**Dardan Fusha – Zëvendësguvernator për
Operacione Bankare, BQK**

1. Themelimi i Grupit Punues për Bankingun e Hapur

Në përputhje me Nenin 6, paragrafi 1 i Udhëzimit për KKP-në, anëtarët e KKP-së miratuan:

- ✓ Termat e referencës për themelimin e Grupit Punues për Bankingun e Hapur;
- ✓ Planin e punës së këtij grupi.

2. Reduktimi i Parasë së Gatshme dhe Nxitja e Pagesave Elektronike

BQK, në koordinim me Banka Botërore dhe anëtarët e Këshillit të vazhdoj aktivitetet e Grupit Punues për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe rritjen e pagesave elektronike.

3. Infrastruktura për sistemit të pagesave të shpejta (TIPS clone) dhe avancimi i funksioneve(upgrade) të KIPS-it:

- ✓ Të vazhdon puna e grupit teknik për implementimin e Sistemit të Pagesave të Shpejta-TIPS clone, si dhe ngritjen e funksioneve(upgrade) në sistemin e KIPS-it.
- ✓ Pjesëmarrësit të përgatiten për përshtatjen teknike të tyre për TIPS-clone dhe KIPS-upgrade.
- ✓ BQK të koordinoj përzgjedhjen e ofruesit të shërbimit të rrjetit për TIPS-clone (SWIFT apo NEXI).
- ✓ Të analizohen opsionet për implementimin e funksioneve mbështetëse (overlay services), si QR code, Request to Pay, Proxy ID, Verification of Payee, etj.

4. Zbatimi i Ligjit për Shërbimet e Pagesave

BQK të vazhdoj rishikimin dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për implementim të Ligjit për Shërbime të Pagesave.

5. Përgatitja për SEPA

Të vazhdoj puna e grupit punues për përgatitjen e ofrueseve të shërbimeve të pagesave për aplikim në skemat e SEPA (CT, CT Inst, DD), si dhe përzgjedhjen e operatorëve për procesim të pagesave në SEPA.

6. Rishikimi i Tarifave për Pagesat Ndërkombëtare

Në funksion të plotësisimit të kriterëve për SEPA, Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave të fillojnë përgatitje për rishikimin e tarifave për transaksionet e pagesave ndërkombëtare.

7. Zbatimi i rregullores për IBAN nga Thesari/MFPT dhe IFJB-të

Pas implementimit të rregullores së IBAN në 2024, të mundësohet shpërndarja e të gjitha llojeve të pagesave për klientët e IFJB-ve (shpenzime, paga, pensione dhe skemat e ndryshme sociale etj).

8. Edukimi Financiar i Përdoruesve

Të vazhdojnë aktivitete për organizimin dhe mbështetjen e kampanjave për edukimin financiar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përdorimin, përfitimet, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike.

9. Digjitalizimi e Pagesave për Shërbimet Publike

Thesari/MFPT të përmirësojnë infrastrukturën që institucioneve publike të mund te pranojnë pagesa për shërbimet përmes kartave dhe instrumenteve tjera elektronike (krahas shërbimeve në e-Kosova).

10. Qasja e IFJB-ve në Sistemin e Pagesave

BQK të vazhdoj draftimin e akteve nënligjore për caktimin e kriterëve, komfor standardeve dhe praktikave në BE, që të mundësojnë qasjen e IFJB-ve në sistemin e pagesave.

11. Platformat Ndërkombëtare të Pagesave

Të vazhdojnë angazhimet për përfshirjen e Kosovës në platformat ndërkombëtare të pagesave online, si: PayPal, ApplePay, etj (pas përfshirjes së suksesshme në GooglePay);

12. Mundësimi i Verifikimit të Adresave dhe të Klientëve për KYC dhe SEPA

Të mundësohet verifikimi i të dhënave të klientëve dhe adresave të tyre për bankat dhe IFJB-të në funksion që të krijohen lehtësira për njohjen e klientit (KYC), si dhe verifikimin e të paguarit (Verification of Payee). OSHP-te (banka dhe IFJB) të angazhohen që brenda një periudhe sa më të shkurt të përmirësojnë të dhënat e klientëve, si: ID e klientit, adresat, statusi rezidencial dhe raportimin e tyre në Regjistrin e Llogarive.

13. Realizimi i Objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (SKPVV)

KKP konstaton se janë arritur dhe tejkaluar objektivat e Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlera të Vogla SKPVV (2021–2026), një vit para 2026 që ishte përcaktuar si target:

- ✓ Përfshirja financiare 73% e popullsisë së moshës madhore të ketë një llogari financiare, krahasuar objektivit prej 70% në 2026 nisur nga niveli prej 52% në vitin 2017.
- ✓ Rritja e numrit të pagesave jo cash në 48.8 kundrejt objektivit që të arrihej në 25 pagesa për kokë banori, deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare është marr nr.17.3 pagesa në vitin 2019.

14. Raportimi i Grupeve Punuese dhe Takimet e Ardhshme

Anëtarët e KKP-se, pajtohen që takimet e radhës të organizohen edhe më shpesh në rast të nevojës për përcjelljen e projekteve gjatë kësaj periudhe, bazuar edhe në raportimet e rregullta nga grupet punuese për çështje që mund të kërkojnë mbështetjen e këshillit për mbështetjen e standardizimit dhe adaptim të rregullave dhe infrastrukturës së nevojshme teknike.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Q & A

Këshilli Kombëtar i Pagesave



Payment.Systems@bqk-kos.org



+383 38 222 055



www.bqk-kos.org